

GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

për

GJYKATËN E APELIT NË PRISHTINË

GJYKATA THEMELORE
OSNOVNI SUD
PRISHTINE-PRISTINA
PRANUAR PRIMLJENO

2018 NOV 16 PM 2: 58

NR. SHKR. BR. SPICA

NUMRI I LËNDËS:

C.nr.2884/18

PROPOZUESI/PADITËSI:

Mejdi Bektashi, Rr. Anton Çeta nr.14, 10000
Prishtinë, Kosovë, i përfaqësuar nga Avokatët
Hamdi Podvorica dhe Arsim Bilalli, me seli në
Prishtinë

**KUNDËRSHTARJA E PROPOZIMIT/
E PADITURA:**

OJQ Admovere, me numër të regjistrimit
5200390-3 dhe numër fiskal 601770119, me
adresë në Rr. Ulpianë C15, Hyrja 10, nr. 6,
10000 Prishtinë, Kosovë, e përfaqësuar nga
Avokatja Rina Kika, me adresë në Rr. Miss
Edith Durham B1 Hyrja 1 Nr. 11, 10000
Prishtinë, (sipas Autorizimit në shkresat e
lëndës)

DATA:

16.11.2018

LËNDA:

Ankesë ndaj Aktvendimit Nr C.nr.2884/18
për caktimin e masës së sigurisë

OBJEKTI I KONTESTIT:

Padi për shpifje me propozim për caktimin e
masës së sigurisë

OJQ Admovere (në vazhdim: "**Kundërshtarja e propozimit**") duke u bazuar në nenin
310, paragrafi 1, nenin 208, nenin 181, paragrafi 1 i Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën
Kontestimore ("**LPK**"), brenda afatit ligjor paraqet këtë:

ANKESË

ndaj

Aktvendimit Cnr.2884/18 për caktimin e masës së sigurisë

të nxjerrë më datë 08.11.2018 nga Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i
Përgjithshëm dhe e kundërshton të njëjtin në tërësi për shkak të:

- 1) shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore,
- 2) konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe
- 3) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Baza faktike

1. Më datë **4 shkurt 2007**, Gazeta Express publikon artikullin “Shumë Plagjiaturë” me autor gazetarin Jasmin Rexhepi.¹ Artikulli i gazetës flet për problemin e përgjithshëm të plagjiaturës në Kosovë e sidomos kur plagjiatorë janë vetë profesorët. Nëntitulli i artikullit të gazetës është si vijon:

“Libri “Ekonomia” i autorëve Mejdj Bektashi dhe Nysret Gacaferri, është njëri ndër shumë librat që përmbajnë plagjiat. Pjesa më e madhe e këtij libri është shkruar duke vjedhur nga libri i autorëve të njohur botërorë, Paul A. Samuelson dhe William D. Nordhaus, i botuar në gjuhën kroate në vitin 1992”.
2. Artikulli më tej, thekson: “Ata kanë vazhduar të shkruajnë në librin e tyre shumë pjesë të librit të Samuelson dhe Nordhaus, ndërsa shumicën e tyre nuk i kanë cituar në libër prej kujt i kanë marrë.” Në artikull citohen paragrafet nga libri “Ekonomia” i autorëve Mejdj Bektashi dhe Nysret Gacaferri, të cilat gazetari Rexhepi i cilëson si plagjiaturë e po ashtu përmenden, ndër të tjera, edhe faqet ku gjenden këto paragrafe: faqe 54, faqe 57 si dhe citohet një definicion i cili gjendet në faqe 58 të librit (Prova nr.2). Gazetari Rexhepi në artikull madje i citon edhe faqet e librit të Paul Samuelson dhe William Nordhaus nga të cilat pretendon se janë marrë paragrafet nga Mejdj Bektashi dhe Nysret Gacaferri, janë vendosur në librin e tyre “Ekonomia” pa i cituar fare (Prova nr.2).
3. **Që nga data 4 shkurt 2007 e deri më sot**, artikulli i Gazetës Express me titull “Shumë Plagjiaturë” me autor gazetarin Jasmin Rexhepi nuk është demantuar/përgënjeshtuar asnjëherë publikisht, as nga Gazeta Express e as nga Propozuesi. Artikulli sot e kësaj dite është i qasshëm për publikun në arkivën e Bibliotekës Kombëtare Universitare të Kosovës, ku ruhen numrat e gazetave të publikuara në Kosovë.
4. Më **23 nëntor 2017**, Kundërshtarja e Propozimit nënshkruan kontratën e grantit për financim të projektit me Fondacionin e Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), për realizimin e projektit “UP nga brenda”. Qëllim i projektit është realizimi i një publikimi që i identifikon problemet kryesore me të cilat ballafaqohen njësitë akademike të UP-së duke marrë për bazë intervistimet e udhëheqësve të këtyre njësive (dekanët) dhe profesorët kritik ndaj këtyre njësive.² Në muajt **mars, prill dhe maj 2018** Kundërshtarja e propozimit i ka intervistuar në kuadër të projektit “UP nga brenda”, 10 nga 13 dekanë të fakulteteve të UP-së dhe që të gjithë përgjigjen se nuk dinë për ndonjë rast të plagjiaturës të pjesëtarëve të stafit akademik të fakultetit që drejtojnë. Ndërkaq, nga 40 pjesëtarë të stafit akademik që janë intervistuar nga Kundërshtarja e propozimit, 34 kanë thënë se nuk dinë dhe/ose nuk besojnë të ketë pasë ndonjë rast plagjiature.
5. Kundërshtarja e propozimit e fillon hulumtimin për mbledhjen e të gjitha rasteve të plagjiaturave për të cilat është raportuar nëpër media që nga themelimi i Universitetit të Prishtinës. Në arkivin e Bibliotekës Kombëtare Universitare të Kosovës, Kundërshtarja e

¹ Bashkëngjitur në shkresat e lëndës nga Kundërshtarja e propozimit si Prova Nr.1.

² Aplikacion për grante KFOS, Admovere 22 shtator 2017, faqe 2, paragrafi i fundit i bashkëngjitur në shkresat e lëndës nga i bashkëpedituri, Luan Shllaku si Prova Nr.3.

propozimit e gjen rastin e profesorit të Fakultetit të Filozofisë, Ali Dida të vitit 1985. Ndërkaq, rastet e fundit të cilat i hasë gjatë hulumtimit Kundërshtarja e propozimit janë rasti i profesoreshës Drita Konxheli nga Fakulteti i Ekonomisë dhe rasti i profesorit Selim Bezeraj nga Fakulteti i Filozofisë për të cilat mediat kanë raportuar në vitin 2016. Gjatë hulumtimit, Kundërshtarja e propozimit arrin t'i gjejë gjithsej 16 raste të plagjiaturës të publikuara nëpër medie dhe vëren se nga gjithsejt 16 pjesëtarë të stafit akademik të UP-së të cilëve u janë shpalosur plagjiaturat në media, shumica nuk kanë reaguar asnjëherë publikisht ndaj akuzave. Prej këtyre 16 rasteve, vetëm tre janë suspenduar nga procesi mësimor, mirëpo që të tre më pas janë kthyer. Vetëm njërit – që nuk ka qenë mësimdhënës i rregullt, por i angazhuar – i është ndërprerë kontrata e punës. Pra, edhe kur zbulimet e plagjiaturave të pjesëtarëve të stafit akademik janë publikuar nëpër media, plagjiatorët jo veç që nuk kanë dhënë dorëheqje, por në shumicën dërrmuese të rasteve, as që u janë nënshtruar masave. Në ato pak raste kur ndonjë masë është ndërmarrë, ajo është shfuqizuar më pas. Për më tej, shumë prej të akuzuarve për plagjiaturë edhe janë avancuar.

6. Ndër këto 16 raste, Kundërshtarja e propozimit e gjen edhe artikullin “Shumë Plagjiaturë” të datës 4 shkurt 2007 nga gazetari Jasmin Rexhepi të botuar në Gazetën Express të përmendur më sipër.³ Kundërshtarja e propozimit e siguron librin “Ekonomia” me autor Mejdi Bektashi dhe Nysret Gacaferri dhe e siguron botimin e 19 të librit “Economics” me autor Paul Samuelson dhe Williëm Nordhaus të vitit 2009 për t'i verifikuar të thënat e gazetarit Rexhepi në artikullin e gazetës “Shumë Plagjiaturë”.

7. Kundërshtarja e propozimit i gjen paragrafet e cituara në artikullin e gazetës në librin “Ekonomia” me autor Mejdi Bektashin dhe Nysret Gacaferri, përkatësisht: faqe 54, paragrafi i fundit, faqe 57, paragrafi i parafundit dhe faqe 58, paragrafi 3 dhe vëren se këto paragrafe nuk kanë referenca - citate.⁴ Kundërshtarja e propozimit i gjen paragrafet pothuajse krejtësisht të njëjta në librin “Economics” me autor Paul Samuelson dhe Williëm Nordhaus, dhe atë në faqe 5, paragrafi i fundit, faqe 26, paragrafi i parafundit dhe faqe 27, paragrafi 4.

8. Më datë 25 shtator 2018, Kundërshtarja e propozimit e publikon Raportin “Stafi Akademik i UP-së – studimet, angazhimet tjera, plagjiaturat, vlerësimet e profesorëve dhe përpjesa staf-studentë e student-hapësirë” (në vazhdim “Raporti”). Raporti i përmban gjashtë kapituj, ndërkaq kapitulli i tretë ka për qëllim radhitjen e të gjitha rasteve të plagjiaturës të pjesëtarëve të stafit akademik të Universitetit të Prishtinës, për të cilat është raportuar në media përgjatë viteve, që nga vetë themelimi i Universitetit.

9. Në faqe 43, paragrafi 1 i Raportit, Kundërshtarja e propozimit e në Raport e përfshinë rastin e 12 të plagjiaturës duke ripublikuar informatat nga Artikulli i Gazetës “Express” me titull “Shumë Plagjiaturë” me autor gazetarin Jasmin Rexhepin, të botuar më datë 4 shkurt 2007 si vijon:

“RASTI: MEJDI BEKTASHI

Në shkurt 2007 Gazeta «Express» boton një artikull me titull «Shumë plagjiaturë» për librin «Ekonomia» të autorëve Mejdi

³ Bashkëngjitur në shkresat e lëndës nga Kundërshtarja e propozimit si Prova Nr.1.

⁴ Bashkëngjitur në shkresat e lëndës nga Kundërshtarja e propozimit si Prova Nr.2.

Bektashi e Nysret Gacaferri. Në shkrim thuhet se «pjesa më e madhe e këtij libri është shkruar duke vjedhur» nga libri i autorëve të njohur botërorë Paul Samuelson dhe William Nordhaus, i botuar 14 herë në gjuhën kroate me titull «Ekonomija». Shkrimi madje citon paragrafë të tërë të vjedhur e të përkthyer me shumë gabime. Autorët nuk kanë reaguar ndonjëherë ndaj këtyre akuzave. Ndërsa Gacaferri është pensionuar shumë vjet para se të zbulohet plagjiatura, Bektashi jo veç që vazhdon me qenë profesor në Juridik, por madje është avancuar.»

10. Më 1 tetor 2018 në Gjykatën Themelore në Prishtinë Propozuesi paraqet padi për shpifje me propozim për lëshimin e masës së sigurisë ndaj Kundërshtares së propozimit, për shkak të publikimit të Raportit, në të cilin në faqe 43, paragrafi 1 citohet artikulli i Gazetës Express i vitit 2007 që flet për librin “Ekonomia” me autor Propozuesin dhe Nysret Gacaferri.⁵ Propozuesi në padi pretendon se Kundërshtarja e propozimit ka shpifur ndaj tij sepse, **e ka ditur** se po e publikon një lajm të pavërtetë “me përmbajtje të porositur”, pasi që e ka ditur se ka ekzistuar një hetim në kuadër të Universitetit në lidhje me rastin nga i cili komisioni hetimor ka konstatuar se **“libri i kontestuar nuk përmbanë asnjë element të plagjiaturës”**. Propozuesi i ka propozuar gjykatës që në bazë të nenit 297 dhe 300 LPK të caktojë masë të sigurisë në mënyrë (1) t’ia ndalojë të paditurve publikimin e çfarëdo lloj deklarate prononcimi, njoftimi, informacioni, raporti etj, në lidhje me Propozuesin dhe (2) të urdhërojë të paditurit që t’i fshijnë të gjitha raportet dhe deklaratat e publikuara, dhe të tërheqin nga qarkullimi Raportin në tirazh prej 300 kopjesh dhe nga web faqja e mediat e shkruara, deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata.

11. Prandaj Propozuesi kërkon nga Gjykata që të caktohet masa e sigurisë ndaj Kundërshtares së propozimit për shkak të rrezikut të shkaktimit të dëmit të pariparueshëm nga Kundërshtarja e propozimit. Propozuesi padisë ia bashkëngjet si provë **Vendimin e Rektorit të Universitetit të Prishtinës nr.1/191 të datës 10 maj 2007** ku theksohet si vijon:

“Libri “Ekonomia”, botimi i dytë i plotësuar, i autorëve Dr. Sc. Mejd Bektashi dhe Mr. Sc. Nysret Gacaferri, botuar më 2005 në Prishtinë nga Fakulteti Juridik – Universiteti i Prishtinës, nga shtypshkronja “Grafobeni”, i autorizuar si tekst universitat me vendimin e Këshillit Botues të UP-së nr.117/36 i datës 12 qershor 1997, faqe 259, **NUK ËSHTË PLAGJIAT NË KUPTIM TË VENDIMIT TË SENATIT TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS NR.112, DATË 12 JANAR 2007 MBI MBROJTJEN E PRONËSISË INTELEKTUALE**”.

12. Në vendimin e Rektorit të Universitetit të Prishtinës nr.1/191 të datës 10 maj 2007 theksohet se Senati i Universitetit të Prishtinës e ka themeluar komisionin vlerësues

⁵ Admovere, Stafi Akademik i UP-së – studimet, angazhimet tjera, plagjiaturat, vlerësimet dhe përpjesa staf-studentë, 2018, <http://admovere.org/stafi-akademik-i-up-se/>.

për hetimin e pretendimeve të ngritura nga gazetari Jasmin Rexhepi në artikullin e Gazetës Express me titull “Shumë Plagjiaturë” i datës 4 shkurt 2007. Pavarësisht se e gjithë kjo ka filluar për shkak të artikullit të gazetës, vendimi në fjalë i dërgohet vetëm palëve si në vijim: Palëve Ass.Prof. Mejd Bektashi e Mr. Sc. Nysret Gacaferri, Dekanit të Fakultetit Juridik, Ass. Prof. Hava Bujupi, Senatit të UP-së dhe Arkivit të UP-së. Vendimi nr.1/191 nuk është i qasshëm në ueb faqen e Universitetit të Prishtinës dhe nuk është publikuar as në Gazetën Express apo ndonjë medium tjetër.

13. Më **2 tetor 2018** Kundërshtarja e propozimit paraqet kërkesë për qasje në dokumente publike në Universitetin e Prishtinës dhe kërkon që t’i sigurohet Vendimi i Senatit Nr.112 i datës 12 janar 2007.

14. Më **13 tetor 2018**, Kundërshtarja e propozimit paraqet përgjigjen në masën e sigurisë me argumentet ligjore që dëshmojnë se deklarata e kontestuar është e mbrojtur sipas Ligjit Nr. 02/L-65 Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes (“**Ligji kundër Shpifjes dhe Fyerjes**”). Bashkë me përgjigjen në kërkesën e masës së sigurisë Kundërshtarja e propozimit i paraqet gjykatës dy prova: **Prova Nr.1:** Artikulli “Shumë Plagjiaturë” nga Jasmin Rexhepi i botuar në Gazetën Express të datës 4 shkurt 2018 si dhe **Prova Nr.2:** faqet 54, 57, 58 të librit “Ekonomia” nga Mejd Bektashi dhe Nysret Gacaferri si dhe faqet 5, 26 dhe 27 të librit Economics të Paul Samuelson dhe Williem Nordhaus.

15. Më **16 tetor 2018** Kundërshtarja e propozimit e paraqet përsëri kërkesën për qasje në dokumente publike në Universitetin e Prishtinës dhe kërkon që t’i sigurohet Vendimi i Senatit Nr.112 i datës 12 janar 2007.

16. Më **22 tetor 2018**, Kundërshtarja e propozimit e përfaqësuar nga avokatja e paraqet kërkesën e tretë me radhë për qasje në dokumente publike në Universitetin e Prishtinës dhe kërkon që t’i sigurohet Vendimi i Senatit Nr.112 i datës 12 janar 2007 si dhe vlerësimi i komisionit të ekspertëve nën kërcënimin e ndërmarrjes së hapave ligjor po që se nuk sigurohen dokumentet përkatëse.

17. Më **24 tetor 2018**, Universiteti i Prishtinës e dërgon përmes emailit Vendimin e Senatit Nr.112 i datës 12 janar 2007. Vendimi në fjalë në paragrafin e parë thekson si vijon:

“Në rast se teksti Universitar i cili është shkruar nga mësimsdhënësi i Universitetit para datës së marrjes se këtij vendimi e që ka karakter akademik është tekst në të cilin mbi 70% të tij është i cituar apo është i njëjtë me ndonjë tekst tjetër në gjuhën shqipe apo i përkthyer nga gjuhet e huaja si i tillë mund të konsiderohet si plagjiaturë.”

18. Më **29 tetor 2018** gjatë seancës për caktimin e masës së sigurisë pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Kundërshtarja e propozimit e paraqet si provë Vendimin e Senatit Nr.112 i datës 12 janar 2007.

19. Më **9 nëntor 2018**, Kundërshtarja e propozimit e pranon vendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë me të cilin është vendosur të caktohet masa e sigurisë ndaj Kundërshtares së propozimit me të cilën Kundërshtares së propozimit i ndalohe t’i përsërisë në të ardhmen sjelljet e publikimit, deklaratat, njoftimin, apo informacionin, në

raport me personalitetin e Propozuesit të sigurimit, lidhur me Raportin, vetëm në pjesën e sigurimit që ka të bëjë me Propozuesin dhe detyrohet të tërheqë nga publikimi-qarkullimi i mëtejshëm Raportin, nga mediat e shkruara, elektronike, web-faqe të internetit dhe në rrjete sociale, vetëm pjesën e Raportit që ndërlidhet me personalitetin e Propozuesit, deri në përfundimin e kontestit me aktgjykim të formës së prerë apo deri në një vendim tjetër të gjykatës.

BAZA JURIDIKE

20. Kundërshtarja e propozimit e paraqet këtë ankesë brenda afatit ligjor dhe e kundërshton në tërësi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë me të cilin është aprovuar kërkesa për caktim të masës së sigurisë (në vazhdim: “**Aktvendimi**”) në pajtim me nenin 181, paragrafi 1 LPK për shkak të:

- I. Shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore,
- II. Konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike,
- III. Zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

I. Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore

21. Siç do të argumentohet në vijim, Gjykata Themelore (“**Gjykata**”) me nxjerrjen e Aktvendimit për caktimin e masës së sigurisë nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat e LPK-së. Saktësisht, Gjykata: (a) nuk i ka marrë fare për bazë faktet dhe provat e paraqitura në procedurë nga Kundërshtarja e propozimit (b) Dispozitivin e aktvendimit e ka nxjerrë në kundërshtim me pjesën e arsytimit të aktvendimit dhe (c) nuk ka aplikuar drejt dispozitat e LPK-së në lidhje me caktimin e masës së sigurisë.

22. Në fund, por jo për nga rëndësia, do të paraqesim argumente se si shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, kanë privuar Kundërshtaren e sigurimit nga E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm e paraparë me Nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (tutje si “Kushtetuta”) dhe Nenin 6 paragrafi 1 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (tutje si “KEDNJ”).

(a) Gjykata nuk i ka marrë fare për bazë faktet dhe provat e paraqitura në procedurë nga Kundërshtarja e propozimit

23. Kundërshtarja e propozimit konsideron se gjatë nxjerrjes së vendimit për caktimin e masës së sigurisë, Gjykata ka shkelur dispozita thelbësore të procedurës kontestimore. Konkretisht, në arsytimin e Aktvendimit në fjalë, Gjykata ka dështuar të përfshijë faktet dhe provat e parashturara nga ana e Kundërshtares së sigurimit, si dhe nuk ka vërtetuar fare faktet dhe provat e paraqitura nga ajo. Neni 160, paragrafi 4 LPK konkretisht përcakton se:

“Arsyetimi i aktgjykimit përmban: kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka

vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato.”

24. Ndërkaq, sipas nenit 174 LPK, dispozitat në lidhje me nxjerrjen e aktgjykimit zbatohen përshtatshmërisht edhe për nxjerrjen e aktvendimeve. Andaj neni 160, paragrafi 4 LPK zbatohet përshtatshmërisht edhe në nxjerrjen e aktvendimit për caktimin e masës së sigurisë.

25. Arsyetimi i Aktvendimit për caktimin e masës së sigurisë dëshmon se Gjykata Themelore në Prishtinë nuk i ka marrë parasysh në tërësi pretendimet dhe provat qenësore për çështjen e parashtruar nga Kundërshtarja e propozimit. Përkatësisht, Kundërshtarja e propozimit më datë 13 tetor 2018 dhe 29 tetor 2018 ia ka paraqitur gjykatës, **tri prova:**

(i) **Prova Nr.1** – Artikulli “Shumë Plagjiaturë” nga Jasmin Rexhepi i botuar në Gazetën Express më 4 shkurt 2007 dëshmon se deklarata të cilën Propozuesi i sigurimit e cilëson si shpifje ka qenë publike që nga viti 2007 dhe për më tepër nuk është denoncuar/përgënjeshtuar asnjëherë. Fakti se nuk është përgënjeshtuar asnjëherë artikulli në fjalë, është fakt jokontestues dhe është konfirmuar nga Propozuesi në Padinë e paraqitur pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe në seancën e datës 29 tetor 2018. Përpjekjet e Propozuesit për ta përgënjeshtuar artikullin në fjalë janë krejtësisht të parëndësishme për këtë çështje kontestuese, pasi që përgënjeshtrimi/demantimi duhet të jetë publik. Fakti që Propozuesi asnjëherë nuk ka paraqitur padi për shpifje ndaj Gazetës Express në lidhje me artikullin apo në lidhje me mos-demantimin e artikullit pas nxjerrjes së Vendimit të Rektorit nr.1/191 të datës 10 maj 2007 është dashur po ashtu të merret parasysh nga Gjykata gjatë vlerësimit të kërkesës për caktimin e masës së sigurisë në këtë çështje kontestuese.

(ii) **Prova Nr.2** - Faqet 54, 57, 58 të librit “Ekonomia” nga Mejdî Bektashi dhe Nysret Gacaferri si dhe faqet 5, 26 dhe 27 të librit “Economics” të Paul Samuelson dhe Williëm Nordhaus, dëshmon se Kundërshtarja e propozimit, në momentin e ripublikimit të Artikullit të Gazetës Express të datës 4 shkurt 2007, i ka krahasuar paragrafet e cituara në artikull dhe në këtë mënyrë ka verifikuar gjetjet e artikullit. As kjo provë nuk është marrë parasysh nga Gjykata në arsyetimin e Aktvendimit.

(iii) **Prova Nr.3** – Vendimi Nr.112 i Senatit të Universitetit të Prishtinës i datës 12 janar 2007 i është dorëzuar Gjykatës gjatë seancës së datës 29 tetor 2018 nga Kundërshtarja e sigurimit. Ky vendim amnistion plagjiaturat deri në 70% për librat e Universitetit të Prishtinës që janë botuar para vitit 2007. Shqyrtimi i Vendimit Nr.112 është thelbësor për shkak se Vendimi Nr.1/191 i Rektorit të UP-së, me të cilin konstatohet se libri “Ekonomia” nuk është plagjiaturë, është nxjerrë duke u bazuar në Vendimin nr.112 të Senatit të UP-së. Prandaj kjo provë është dashur të merret parasysh nga Gjykata gjatë vlerësimit se a e ka bërë të besueshme kërkesën për caktimin e masës së sigurisë Propozuesi për shkak pretendimit për shpifje dhe rrezikut për shkaktimin e dëmit të pariparueshëm. As kjo provë nuk merret parasysh në arsyetimin e Aktvendimit për caktimin e masës së sigurisë.

Gjykata në arsyetim të vendimit të saj thirret në Vendimin nr. 1/191 të datës 10 maj 2007 të nxjerrë nga Rektori i Universitetit të Prishtinës. Ky vendim thekson se “Libri “Ekonomia” (...) **nuk është plagjiat në kuptim të vendimit të Senatit të Universitetit të Prishtinës nr.112, datë 12 janar 2007 mbi mbrojtjen e pronësisë intelektuale**”. Rrjedhimisht, është e pamundur që Vendimi nr.1/191 i Rektorit të Universitetit të Prishtinës i datës 10 maj 2007 të vlerësohet ndaras nga Vendimi Nr.112 i Senatit të Universitetit të Prishtinës sepse ky i fundit është vetë baza mbi të cilën është konstatuar se Libri “Ekonomia” nuk është plagjiaturë. Asnjëra nga këto vendime nuk kanë qenë vendime të publikuara apo të qasshme për publikun.

26. Rrjedhimisht, vetë fakti se asnjëra nga këto prova nuk përmendet në Aktvendimin e Gjykatës për caktim të masës së sigurisë tregon se ky Aktvendim është nxjerrë në shkelje të nenit 160, paragrafi 4 LPK i cili e obligon gjykatën të shqyrtojë faktet dhe provat e paraqitura nga palët në arsyetim të vendimit.

27. Shkelja e nenit 160, paragrafi 4 LPK në bazë të nenit 182, paragrafi 1 LPK krijon bazën ligjore të ekzistimit të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore sepse sipas nenit 182, paragrafi 1 LPK:

“Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston në çoftë se **gjykata gjatë procedurës nuk e ka zbatuar** apo ka zbatuar në mënyrë jo të drejt ndonjë dispozitë të këtij ligji, kurse kjo ka pasur apo ka mundë të ketë ndikim në nxjerrjen e aktgjykimit të ligjshëm e të drejtë.”

28. Po qe se Gjykata do të merrte parasysh faktet dhe provat e paraqitura nga Kundërshtarja e sigurimit, përfundimi i Gjykatës në lidhje me caktimin e masës së sigurimit patjetër se do të ndikonte në nxjerrjen e Aktvendimit. Madje përfundimi i Gjykatës do të ishte krejtësisht i kundërt sepse në bazë të këtyre provave vërtetohet se Kundërshtarja e sigurimit nuk është autore e deklaratës të cilën Propozuesi pretendon se është deklaratë shpifëse, si dhe nuk ka kontribuar në përhapjen e deklaratës e cila pretendohet të jetë shpifëse meqë deklarata në fjalë (Artikulli i Gazetës Ekspres) nuk është demantuar apo përgenjështuar nga Propozuesi asnjëherë. Ndërkaq Vendimi Nr.1/191 i Rektorit të Universitetit në lidhje se a është plagjiat apo jo libri “Ekonomia” nuk është bërë asnjëherë publik.

(b) Dispozitivi i Aktvendimit është kontradiktor me pjesën e arsyetimit të Aktvendimit

29. Në Aktvendimin për caktimin e masës së sigurisë është e qartë se dispozitivi me të cilin (i) aprovohet propozimi i Propozuesit të sigurimit dhe caktohet masa e sigurimit, (ii) detyrohet Kundërshtarja e sigurimit që të tërheqë nga publikimi-qarkullimi i mëtejme Raportin në fjalë, është në kundërshtim me pjesën e arsyetimit të Aktvendimit sepse në paragrafin 3, faqe 4 të Aktvendimit, Gjykata vlerëson dhe konstaton se qëllimi i Raportit të Kundërshtares së sigurimit nuk ka qenë të lëndojë askënd, mirëpo t’i mbledh rastet e publikuara në media si plagjiaturë duke filluar nga viti 1985.

30. Tutje, Gjykata ka vlerësuar në paragrafin 3, faqe 4 të Aktvendimit se Propozuesi e ka bërë të besueshëm ekzistimin e kërkesës së tij në bazë të nenit 297, paragrafi 1 LPK në

lidhje me nenin 4, paragrafi 1 të Ligjit kundër Shpifjes dhe Fyerjes. Neni 4, paragrafi 1 i Ligjit Kundër Shpifjes dhe Fyerjes përcakton se:

“Një person ka të drejtë të kërkojë përmes procedurës gjyqësore të ndalë shpifjen dhe fyerjen dhe premtimin se shpifja apo fyerja nuk do të përsëritet në të ardhmen, tërheqjen e informacionit shpifës apo fyes ndaj personalitetit të tij/saj dhe kompensimin për dëmin moral dhe material të shkaktuar nga shpifja dhe fyerja, **përveç nëse është konstatuar njëra nga përjashtimet e përgjegjësisë në pajtim me këtë Ligj.**”

31. Përjashtimet e përgjegjësisë janë të rregulluara me neni 7 të Ligjit kundër Shpifjes dhe Fyerjes, i cili përcakton si vijon:

“**Askush nuk do të jetë përgjegjës për shpifje dhe fyerje për një deklaratë të një çështjeje me interes publik**, nëse ata dëshmojnë se ishte e arsyeshme në të gjitha rrethanat për një person në pozitën e tyre **të përhapte materialin me qëllim të mirë**, duke marrë parasysh rëndësinë e lirisë së shprehjes në lidhje me çështje të interesit publik që ai të marrë në kohë informacion për çështje të tilla.”

32. Në paragrafin 3, faqe 4 të Akvendimit, Gjykata vlerëson dhe konstaton se qëllimi i Raportit të Kundërshtares së sigurimit nuk ka qenë të lëndojë askënd por t’i mbledhë rastet e publikuara në media si plagjiaturë duke filluar nga themelimi i Universitetit të Prishtinës. Përkundër asaj që Gjykata qartazi në arsyetim ka konstatuar qëllimin e mirë të Kundërshtares së Propozimit, që njëkohësisht paraqet bazë për përjashtimin e përgjegjësisë, e njëjta në dispozitivin e Aktvendimit ka aprovuar kërkesën e Propozuesit duke e vlerësuar se e ka bërë të besueshem ekzistimin e të drejtës subjektive.

33. Mos-përputhja e tillë në mes të arsyetimit dhe dispozitivit të Aktvendimit paraqet shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, e paraparë me nenin 182, paragrafi 2, nënparagrafi n LPK, sipas të cilit ndër tjera:

“në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos **në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit[...].**”

34. Prandaj, konstatimi i qëllimit të mirë të publikimit të Raportit nga Kundërshtarja e propozimit është bazë që e përjashton përgjegjësinë për shpifje dhe si e tillë e bën të pakuptimtë caktimin e masës së sigurisë.

(c) Gjykata nuk ka aplikuar drejtë dispozitat e LPK-së në lidhje me caktimin e masës së sigurisë

35. Me rastin e caktimit të masës së sigurisë Gjykata ka dështuar të aplikojë drejt dispozitat relevante të LPK-së për të vlerësuar se a ekziston baza e mjaftueshme faktike dhe ligjore për caktimin e masës së sigurisë. Detyra e Gjykatës me rastin e vlerësimit të caktimit të masës së sigurisë sipas nenit 297, paragrafi 1 LPK ka qenë të përcaktojë:

A. në qoftë se propozuesi i sigurimit e ka bërë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive të tij, dhe

B. në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, fshehjes së saj, me ngarkim apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do të ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.

36. Sa i përket parakushtit A të nenit 297 paragrafi 1 LPK, Gjykata e Apelit duhet të ketë parasysh se Gjykata Themelore në Aktvendim për caktim të masës së sigurisë faqe 3, paragrafi 4 në mënyrë absurde konstaton se:

“Nga vendimi me nr. 1/191 i datës 10.05.2007, i lëshuar nga UP-ja, gjykata ka konstatuar se botimi me shkrim në Gazetën “Ekspress” i datës 04.02.2007 me titull “Shumë Plagjiaturë” që ndërlidhet me Librin “Ekonomia”, [...] botuar në vitin 2005 [...] nuk është plagjiat i librit në gjuhën kroate “Ekonomija” [...]”

37. Përveç që formulimi i lartëcekur është i paqartë, i njëjti nuk e bënë kërkesën e Propozuesit për ekzistimin e të drejtës subjektive të tij si të besueshme meqë artikulli i Gazetës “Ekspress” është publikuar qysh në vitin 2007 dhe vazhdon të jetë i qasshëm pa u demantuar dhe pa u përgënjeshtuar asnjëherë nga ana e Propozuesit.

38. Tutje, në faqe 3, paragrafi 6 i Aktvendimit, Gjykata ka vlerësuar se që nga dita e publikimit të Raportit të Kundërshtares së sigurimit, pra 29 tetor 2018 e tutje, ka pasur fyryje të ndryshme në kushtet e vendit tonë. Gjykata nuk mbështet këtë konstatim me asnjë fakt apo provë të vetme se në çfarë “kushtesh të vendit tonë” ka pranuar fyryje Propozuesi i sigurimit. Gjykata përmend “njoftimin” e Propozuesit të sigurimit të paraqitjes televizive e Drejtorit të Kundërshtares së sigurimit ku ai verbalisht prezenton të gjeturat e Raportit dhe ndër tjera edhe rastin e Propozuesit të sigurimit, por të njëjtin “njoftim” nuk e vlerëson si fakt apo provë në vendimarrjen e Gjykatës. Çka Gjykata konstaton është se qëllimi i Raportit të Kundërshtarit të sigurimit ka qenë të mos lëndojë askënd, mirëpo në të njëjtën kohë e konsideron se Propozuesi i sigurimit e ka bërë të besueshëm ekzistimin e kërkesës së tij bazuar në neni 297, paragrafi 1, pika a LPK, pa elaboruar asnjë fakt apo provë se pse kërkesa e Propozuesit është e besueshme.

39. Sa i përket parakushtit B të nenit 297 paragrafi 1 LPK, Gjykata e Apelit duhet të ketë parasysh se Gjykata Themelore në Aktvendim për caktim të masës së sigurisë faqe 4, paragrafi 4 ka vlerësuar në mënyrë të gabuar se:

“... ekziston rreziku, për realizimin e të drejtës subjektive nga Propozuesi i sigurimit pa lëshimin e masës së sigurisë në këtë rast ngase do të ndikonte negativisht në të drejtat e Propozuesit të Sigurimit, sidomos në rast se kundërshtarja e sigurimit do të përsëriste veprimet e tilla në të ardhmen lidhur me çështjen lëndore, duke u bazuar në nenin 297 paragrafi 1 pika b) [...] në lidhje me nenin 4 paragrafi 1 i Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes.”

40. Përfundimi i lartëcekur i Gjykatës është krejtësisht në kundërshtim me nenin 297, paragrafi 1, pika b LPK sipas të cilit masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se realizimi i kërkesës së Propozuesit do të bëhet i pamundur për shkak të tjetërsimit të

pasurisë së Kundërshtarit apo ndonjë rrethane të ngjashme. Është absurde të konsiderohet se ekziston rreziku të pamundësohet realizimi i kërkesës së Propozuesit se kinse do të ndikonte negativisht në të drejtat e Propozuesit, kur dihet se Raporti i Kundërshtares së sigurimit është i bazuar në një artikull gazete që është publik dhe i qasshëm për gati 12 vite.

41. Tutje, Gjykata Themelore duke ndërlidhur nenin 297, paragrafi 1, pika b LPK me nenin 4, paragrafi 1 i Ligjit kundër Shpifjes dhe Fyerjes sipas të cilit nen "...personi ka të drejtë të kërkojë përmes procedurës gjyqësore të ndalë shpifjen dhe fyerjen...", praktikisht ka konstatuar përtej asaj që kërkesa për masë të sigurisë mundëson, pra ka konstatuar ekzistimin e shpifjes në kuptim të nenit 4, paragrafi 1 i Ligji kundër Shpifjes. Përkundër faktit se Propozuesi nuk ka arritur ta bëjë kërkesën e tij subjektive të besueshme, si dhe nuk ka arritur të argumentojë se ekziston rreziku i pamundësimin të realizimit të kërkesës së besueshme, Gjykata me Aktvendimin për caktimin e masës së sigurisë në kundërshtim me nenin 297, paragrafi 1 LPK, ia ka konstatuar ekzistimin e të drejtës subjektive Propozuesit.

42. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh të lartëcekurat, Aktvendimi për caktimin e masës së sigurisë duhet të anulohet për arsye se është nxjerrë duke shkelur dispozitat e detyrueshme të procedurës kontestimore për nxjerrjen e Aktvendimeve.

Shkeljet kushtetuese si pasojë e shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore

43. Siç u elaborua nga faktet e përmendura më lart, Aktvendimi mbi caktimin e masës së sigurisë ka dështuar t'i shqyrtojë dhe vlerësojë pretendimet thelbësore të Kundërshtares së sigurimit që do të ishin të domosdoshme për vendosje të drejtë në çështjen e kërkesës për caktim të masës së sigurisë. Si rrjedhojë, Kundërshtares së sigurimit i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6, paragrafi 1 të KEDNJ, në atë se Aktvendimi në fjalë nuk përmban arsye të elaboruara mbi faktet e paraqitura nga Kundërshtarja e propozimit. Si pasojë e këtyre shkeljeve, Kundërshtarja e sigurimit po ashtu është privuar nga liria e shprehjes sipas nenit 40 të Kushtetutës dhe nenit 10 KEDNJ, mirëpo ky argument do të paraqitet tutje në kuadër të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

44. Në rastin konkret Kundërshtarja e sigurimit, kishte argumentuar para Gjykatës Themelore në bazë të fakteve dhe provave të paraqitura se nuk është autore e deklaratës e cila pretendohet se është shpifëse, se Kundërshtarja e sigurimit nuk ka qenë as nuk ka pasur si të jetë në dijeni mbi Vendimin nr. 1/191 të datës 10 maj 2007, dhe se Raporti ka qenë raport që ka të bëjë me çështje të interesit publik dhe ka pasur qëllim të mirë. Përveç pretendimit se raporti ka pasur qëllim të mirë, asnjë nga pretendimet tjera qenësore për çështjen nuk janë trajtuar nga Gjykata Themelore në Aktvendimin për caktim të masës së sigurisë. Rëndësia e të drejtës për vendim të arsyetuar mbi faktet e paraqitura të palëve është i njohur mirë në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese (tutje si "GjK") të Republikës së Kosovës dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (tutje si "GjEDNJ").

45. Më saktësisht, GjK në rastin KI22/16 ka theksuar se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni tjetër i një vendimi të arsyetuar është t'u dëshmojë palëve që ato janë dëgjuar [...]. GjK tutje ka potencuar se gjykatat e rregullta nuk janë të obliguara t'i adresojnë të gjitha pretendimet e parashtruara nga palët. Megjithatë ato duhet të adresojnë pretendimet që janë relevante për çështjen në shqyrtim[...].

46. Po ashtu, sipas jurisprudencës të GjEDNJ-së ka pasur shkelje të nenit 6, paragrafi 1 të Konventës në rastin *Hiro Balani kundër Spanjës*, ku parashtruesi kishte paraqitur parashtrësë në gjykatë, me të cilën kërkonte përgjigje të veçantë dhe të qartë.⁶ Gjykata nuk ofroi atë përgjigje, duke e bërë të pamundur të kuptohej nëse ajo thjesht e kishte lënë pas dore të merret me çështjen apo e kishte ndërmend ta refuzojë kërkesën, dhe po të ishte ashtu, cilat ishin arsyet për refuzimin e saj.⁷ Mbase rasti më i mirë në kontekst të lëndës në shqyrtim është vendimi i GjEDNJ *Boldea kundër Romanisë*. GjEDNJ ka konstatuar se gjykata vendore kishte bërë shkelje të së drejtës së lirisë së shprehjes (neni 10 KEDNJ) dhe shkelje të së drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm (neni 6 KEDNJ), pasi që nuk e kishte arsyetuar vendimin në mënyrë të mirëfilltë dhe nuk i kishte marrë parasysh faktet e paraqitura nga pala gjatë vlerësimit të padisë për shpifje që ia kishin bërë kolegët pasi ky i kishte akuzuar për plagjiaturë.⁸

47. Në rastin konkret, pretendimet e Kundërshtares së sigurimit të cilat janë qenësore për të konstatuar se a është e besueshme kërkesa për caktim të masës së sigurisë janë shpërfillë tërësisht nga Gjykata Themelore. Ndërkaq, pretendimet e Propozuesit sipas të cilit kërkesa e tij është besueshme si dhe a ekziston rreziku për realizimin e të drejtës subjektive të tij pa lëshim të masës së sigurisë e ka pranuar pa e arsyetuar fare se në bazë të cilave fakte dhe prova është bërë kërkesa e besueshme dhe në bazë të cilave fakteve dhe provave ekziston rreziku i pretenduar.

48. Aludimi i vetëm dhe absurd i gjykatës është se “ka pasur fyerje në kushtet e vendit tonë” pa sqaruar se cila është domethënia e një konstatimi të tillë dhe cilat janë provat e paraqitura nga Propozuesi në lidhje me këtë. Edhe në këtë drejtim GjK ka gjetur në rastin KI72/12 se arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet gjetjeve të meritave dhe reflektimit, kur t'i shqyrtojë provat e propozuara nga një anë dhe përfundimet ligjore nga ana tjetër. Akgjykimi [në këtë rast Aktvendimi] sipas GjK-së do ta shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimarrje, në rast se arsyetimi i dhënë dështon të përmbajë fakte të vërtetuara, dispozita ligjore si dhe marrëdhënien logjike ndërmjet tyre. Për Kundërshtaren e sigurisë, është krejtësisht jologjike dhe arbitrare të pranohet nga Gjykata pretendimi i Propozuesit se kërkesa e tij është e besueshme pa paraqitur fakte dhe prova dhe pa i shqyrtuar fare pretendimet, faktet dhe provat e paraqitura nga Kundërshtarja e sigurimit në procedurë.

II. Konstatimi i gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike

⁶ *Hiro Balani kundër Spanjës*, Nr. 18064/91, GjEDNJ, 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27.

⁷ Po aty.

⁸ *Boldea kundër Rumanisë*, GjEDNJ, Nr.19997/02, GjEDNJ, 15 shkurt 2007, Komunikatë për shtypin nga GjEDNJ, faqe 2 dhe 3.

49. Sipas nenit 183, paragrafi 1 LPK vërtetimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike ekziston kur gjykata gabimisht e ka vërtetuar ndonjë fakt vendimtar, përkatësisht kur faktin e tillë nuk e ka vërtetuar fare apo kur kemi konstatim jo të plotë të gjendjes faktike. Konstatimi i drejtë i gjendjes faktike ndërlihet shumë me shkeljet procedurale të gjykatës gjatë nxjerrjes së Aktvendimit. Po të ishin vlerësuar saktësisht provat e paraqitura nga Kundërshtarja e propozimit, Gjykata do të kishte qenë në gjendje ta konstatojë gjendjen faktike në mënyrë të drejtë.

50. Në Aktvendim, Gjykata ka dështuar të konstatojë se Kundërshtarja e propozimit nuk është autore e deklaratës e cila pretendohet të jetë shpifje nga Propozuesi. Autor i deklaratës së kontestuar është gazetari Jasmin Rexhepi dhe botuese është Gazeta Express e cila më 4 shkurt 2007 ka botuar artikullin “Shumë Plagjiaturë”. Kjo është dëshmuar me Provën nr.1 të paraqitur pranë Gjykatës nga Kundërshtarja e propozimit.

51. Gjykata ka dështuar të konstatojë se nuk ka pasur përgënjeshttrim të artikullit të botuar në vitin 2007 edhe pse Propozuesi këtë fakt e ka pranuar në Padi dhe në seancë gjyqësore dhe është fakt jetik për të vendosur për kërkesën për caktim të masës së sigurisë siç u spjegua më lart.

52. Gjykata ka dështuar të konstatojë se deklarata që pretendohet të jetë shpifje është çështje e interesit publik, edhe pse kjo është argumentuar nga Kundërshtarja e propozimit.

53. Gjykata nuk e ka trajtuar as Provën Nr.2 të dorëzuar nga Kundërshtarja e propozimit që dëshmon se ka ndërmarrë hapa që të mos kontribuojë në përhapjen e deklaratës e cila pretendohet të jetë shpifëse.

54. Gjykata ka dështuar të konstatojë se Vendimi Nr.1/191 i Rektorit të Universitetit nuk është bërë asnjëherë publik. Edhe po të ishte bërë publik, konstatimet e këtij vendimi, lexuar së bashku me Vendimin Nr.112 të Sentatit të Universitetit të Prishtinës, janë plotësisht në kundërshtim me të gjitha dispozitat e aplikueshme në Kosovë që trajtojnë fenomenin e plagjiaturës. Shih: Nenin 10 të Kodit të Etikës për stafin akademik të Universitetit të Prishtinës Nr.1/751 i datës 19 korrik 2013, nenin 6, paragrafin 1.15 të Rregullores për masat dhe procedurat disiplinore ndaj personelit akademik të Universitetit të Prishtinës Nr.857, i datës 11 prill 2017, neni 296 Kodi Penal i Kosovës. Gjykata Themelore në Aktvendim për caktim të masës së sigurisë faqe 3, paragrafi 4 gabimisht konstaton se:

“Nga vendimi me nr. 1/191 i datës 10.05.2007, i lëshuar nga UP-ja, gjykata ka konstatuar se botimi me shkrim në Gazetën “Ekspress” i datës 04.02.2007 me titull “Shumë Plagjiaturë” që ndërlihet me Librin “Ekonomia”, [...] botuar në vitin 2005 [...] nuk është plagjiat i librit në gjuhën kroate “Ekonomija” [...]”

55. Gjykata gabimisht e konstaton “ka pasur fyerje në kushtet e vendit tonë” pa sqaruar se cila është domethënia një konstatimi të tillë dhe cilat janë provat e paraqitura nga Propozuesi në lidhje me këtë.

56. Është për tu çuditur se si Gjykata e ka vlerësuar si provë të rëndësishme për marrjen e Aktvendimit për caktimin e masës së sigurisë korrespondencën elektronike të Propozuesit me gazetaren e Kallxo.com, Liridona Ademaj. Propozuesi në padinë e paraqitur më datë 1 tetor deklaron si vijon:

“Me bindje të plotë dhe përmes fakteve të shumta (që do t’i prezantojë ne seancë gjyqësore) dyshojë se ekziston një koordinim i mirë i organizuar në mes të disa portaleve dhe shpifësve të paditur që të mos i botojnë reagimet e njerëzve të apostrofuara në këtë “HULUMTIM” të porositur e financuar nga ana e KFOS-it. Si rast më eklatant mund të përmendi rastin e portalit Kallxo.com i cili me datën 24.09.2018, përmes postës elektronike kërkon nga unë që të komentohen kinse të gjeturat e OJQ Admovere.”

57. Kallxo.com nuk është palë në këtë çështje kontestimore dhe Kundërshtarja e propozimit nuk ka kompetencë dhe nuk mund të përgjigjet për vendimet redaktoriale të portalit Kallxo.com. Rrjedhimisht, prova e Propozuesit që paraqet korrespondencën në mes të Propozuesit dhe gazetares Liridona Ademaj nga Kallxo.com është plotësisht e parëndësishme në këtë çështje kontestimore dhe përfshirja e saj si provë për aprovimin e kërkesës për caktim të masës së sigurisë paraqet vërtetim të gabuar të gjendjes faktike.

58. Prandaj, duke u bazuar në të thënat e kësaj pjese dhe në elaborimet e pjesës së parë ku shtjellohen shkeljet procedurale që ndërlidhen me provat e paraqitura në procedurë, mund të përfundojmë se Aktvendimi për caktim të masës së sigurisë është nxjerrë duke konstatuar gabimisht gjendjen faktike.

III. Zbatimi i gabuar i të së drejtës materiale

59. Sipas nenit 181, paragrafi 1, pika c LPK, Aktgjykimi mund të goditet edhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Neni 184 LPK përcakton se

“Zbatimi i gabueshëm i së drejtës materiale ekziston kur gjykata nuk e ka zbatuar dispozitën e së drejtës materiale që është dashur ta zbatojë, apo kur dispozitën e tillë nuk e ka zbatuar në mënyrë të drejtë.”

Zbatimi i gabuar i Ligjit kundër Shpifjes dhe Fyerjes

60. Gjykata në Aktvendim ka përmendur argumentet e Kundërshtares së propozimit se deklarata e kontestuar është e mbrojtur në bazë të neni 7 i Ligjit kundër Shpifjes dhe Fyerjes - deklarata gëzon mbrojtje ligjore sepse është çështje e interesit publik, neni 9 i Ligjit kundër Shpifjes dhe Fyerjes - deklarata gëzon imunitet ligjor sepse është raportim i drejtë i një shoqate që ka për qëllim përmirësimin e arsimit, neni 11, paragrafi 1 Ligjit kundër Shpifjes dhe Fyerjes – Kundërshtarja e propozimit nuk është autore e deklaratës, por vetëm e citon/ripublikon një deklaratë tashmë të botuar. Sidoqoftë, në arsyetim të Aktvendimit nuk është ndalur ta elaborojë asnjërën nga këto baza të përjashtimit të përgjegjësisë për shpifje.

61. Për caktimin e masës së sigurisë, sipas nenit 297 LPK, Gjykata është dashur t’i shqyrtojë provat, rrethanat e rastit dhe të thënat e palëve dhe të shqyrtojë se a janë plotësuar kumulativisht dy kushte të renditura këtu si pika A dhe pika B.

A. A e ka bërë Propozuesi i sigurimit të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive të tij ? – Pra, kërkesës së tij që të konstatohet se Kundërshtarja e propozimit ka shpifur ndaj Propozuesit dhe e ka fyer atë?

Zbatimi i gabuar i të drejtës materiale qëndron në pikat e spjeguar në vijim.

62. Në Aktvendim, Gjykata nuk e trajton a ekzistojnë prova apo fakte që do ta bënin të besueshme kërkesën e Propozuesit që të konstatohet se **Kundërshtarja e propozimit e ka ditur apo është dashur ta dijë se po shpërndanë një deklaratë të pavërtetë sipas nenit 3, paragrafi a dhe b të Ligjit kundër Shpifjes dhe Fyerjes.**

63. Në Aktvendim, Gjykata nuk e trajton asnjërin argument të paraqitur nga Kundërshtarja e propozimit **për përjashtimin e përgjegjësisë për shpifje** sipas nenit 7, nenit 9 dhe nenit 11, paragrafi 1 i Ligjit kundër Shpifjes dhe Fyerjes.

64. Gjykata e konstaton çështjen kryesore: shpifjen pa dhënë arsytim⁹ e pa i trajtuar fare bazat për përjashtimin e përgjegjësisë për shpifje. Këtë konstatim Gjykata e bazon nenin 4, paragrafi 1 i Ligjit kundër Shpifjes dhe Fyerjes ku përcaktohet: “Një person ka të drejtë të kërkojë përmes procedurës gjyqësore të ndalë shpifjen dhe fyerjen dhe premtimin se shpifja apo fyerja nuk do të përsëritet në të ardhmen, tërheqjen e informacionit shpifës apo fyes ndaj personalitetit të tij/saj dhe kompensimin për dëmin moral dhe material të shkaktuar nga shpifja dhe fyerja, **përveç nëse është konstatuar njëra nga përjashtimet e përgjegjësisë në pajtim me këtë Ligj.**”

65. Padia e Propozuesit është bazuar në pretendimin se Kundërshtarja e propozimit ka bërë shpifje dhe fyerje. Gjykata nuk e trajton fare pretendimin për fyerje të Propozuesit nga Kundërshtarja e propozimit sipas nenit 3, paragrafit b të Ligjit kundër Shpifjes dhe Fyerjes. Megjithatë, Gjykata në faqe 4, paragrafi 6 të Aktvendimit konstaton gabimisht “se ka pasur fyerje të ndryshme në kushtet e vendit tonë.” Këtë konstatim, siç u spjegua edhe më lart, Gjykata e bën duke mos dhënë asnjë sqarim të mëtejshëm për faktet apo të drejtën materiale nga e cila e ka nxjerrë këtë përfundim. Prandaj edhe në këtë pikë kemi interpretim të gabuar të së drejtës materiale sa i përket pretendimit për fyerje të Propozuesit.

66. Gjykata thirret në rëndësinë e kufizimit të lirisë së shprehjes në rrethana dhe kushte të caktuara në pajtim me KEDNJ, ndërsa nuk e elaboron cilat kushte janë plotësuar për t’u kufizuar liria e shprehjes në rastin konkret. Po ashtu gjatë shqyrtimit të kushteve në të cilat mund të kufizohet liria e shprehjes Gjykata dështon ta aplikojë praktikën gjyqësore të GJEDNJ, e cila mbizotëron në legjislacionin e Kosovës në interpretimin e të drejtave të njeriut sipas nenit 53 të Kushtetutës së Kosovës dhe sipas nenit 2, paragrafi 1 i Ligjit kundër Shpifjes dhe Fyerjes. Zbatimi i gabuar i të drejtës materiale në këtë aspekt trajtohet në hollësi në paragrafin 69 të kësaj ankese.

B. **A ekziston rreziku se pa caktimin e masës me të cilën detyrohet Kundërshtarja e propozimit të tërheqë nga qarkullimi të gjitha gjitha materialet, postimet, etj. që e përfshijnë deklaratën e kontestuar, Kundërshtarja e propozimit do të mund ta pamundësojë apo vështirësojë dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me**

⁹ Aktvendimi Cnr.2884/2018 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, faqe 4, paragrafi 4.

tjetërsimin e pasurisë, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e Propozuesit të sigurimit?

67. Gjatë vlerësimit të rrezikut Gjykata është dashur të marrë parasysh se deklarata e kontestuar është publikuar më 4 shkurt 2007 nga Gazeta Express dhe asnjëherë nuk është demantuar publikisht, as nga Gazeta Express, as nga Propozuesi e as nga Universiteti. Pra deklarata është publike për gati 12 vite dhe asnjëherë nuk është kontestuar publikisht nga askush. Prandaj, pretendimi se ekziston çfarëdo rreziku që pa caktimin e kësaj mase do t'i shkaktohej dëm apo do të ndikoheshin negativisht të drejtat e Propozuesit është krejtësisht i pabazë.

68. Të dy kushtet e nenit 297 LPK duhet të plotësohen kumulativisht për tu caktuar masa e sigurisë nga Gjykata. Asnjëra nga këto kushte nuk është plotësuar në rastin konkret sipas të drejtës materiale në fuqi.

Zbatimi i gabuar i KEDNJ dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ

69. Në Aktvendim, gjykata e ka trajtuar vetëm një argument të Kundërshtares së sigurimit: argumentin se caktimi i masës së sigurisë do të ishte cënim i drejtëpërdrejtë i lirisë së shprehjes e cila është e drejtë fundamentale e mbrojtur në nenin 40, paragrafi 1 të Kushtetutës së Kosovës. Sipas gjykatës:

“liria e lartëcekur nuk është absolute, sikurse nuk është absolute edhe asnjë e drejtë tjetër në kuptimin e plotë, prandaj mund të ketë restriksione apo kufizime ngase e njëjta mund të kufizohet me ligj, siç përcaktohet me nenin 40, paragrafi 2 i Kushtetutës së Kosovës dhe me nenin 10, paragrafi 2 të Konventës për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”¹⁰

70. Edhe pse nuk është relevante për këtë çështje konstestuee, vlen të theksohet se KEDNJ i njeh dhe i garanton disa të drejta absolute nga të cilat shtetet nënshkruese të konventës nuk mund të derogojnë si: liria nga tortura (neni 3, KEDNJ), liria nga skllavëria (neni 4, paragrafi 1 KEDNJ), e drejta në jetë (neni 2, KEDNJ) dhe e drejta për të mos u gjykuar a sanksionuar për një veprë penale që nuk parashihet me ligj si e tillë (neni 7, paragrafi 1 KEDNJ).

71. Sidoqoftë, gabimi në interpretimin e të drejtës materiale nuk qëndron në faktin se Gjykata e sheh lirinë e shprehjes si të drejtë që mund të kufizohet në rrethana të caktuara. Vlerësimi i gjykatës në këtë pikë është i saktë, por gabimi i saj qëndron në atë se në rastin konkret e ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale gjatë vlerësimit se kur dhe në çfarë rrethanash mund të kufizohet e drejta e lirisë së shprehjes.

72. Sipas nenit 53 të Kushtetutës së Kosovës, interpretimi i të drejtave të njeriut në Kosovë bëhet në harmoni me vendimet gjyqësore të GJEDNJ. Edhe në vetë Ligjin kundër Shpifjes dhe Fyerjes specifikohet mbizotërimi i praktikës së GJEDNJ në raport me këtë ligj në nenin 2, paragrafi 1 i Ligjit kundër Shpifjes dhe Fyerjes.

¹⁰ Aktvendimi Cnr.2884/2018 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, faqe 5, paragrafi 1.

73. Sipas nenit 10, paragrafi 2 KEDNJ, kufizimi i lirisë së shprehjes definohet kështu:

“ 2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, **kufizimeve** ose sanksioneve **të parashikuara me ligj** dhe **që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike**, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, **për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve**, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.”

74. GJEDNJ ka vendosur një mori rastesh që kanë trajtuar çështjen e kufizimit të lirisë së shprehjes dhe ka vendosur disa kritere që duhet të merren parasysh nga gjykatat vendore kur lëshojnë vendime që e kufizojnë këtë të drejtë. Ndërhyrjet e autoriteteve shtetërore në lirinë e shprehjes vlerësohen duke shqyrtuar se a janë aplikuar standarde që janë në përputhje me principet e mishëruara në nenin 10, dhe po ashtu a është bazuar ndërhyrja në një vlerësim të pranueshëm të fakteve të rëndësishme.¹¹ GJEDNJ ka vlerësuar më tej se organizatave të shoqërisë civile të cilat tërheqin vëmendjen për çështje të interesit publik i takon të kenë mbrojtje të përafërt të lirisë së shprehjes me mediet për shkak se OJQ-të e kanë rëndësinë e ngjashme me mediet kur e luajnë rolin e “vrojtuesit publik” (anglisht: social watchdog).

75. Në rastin *Axel Springer AG kundër Gjermanisë*, GJEDNJ ka vendosur se nëse autoritetet shtetërore e kufizojnë lirinë e shprehjes pa i plotësuar kushtet që dalin nga neni 10, paragrafi 2 i KEDNJ, atëherë kemi të bëjmë me shkelje të së drejtës së lirisë së shprehjes.¹² Kushtet që duhet vlerësuar nga gjykatat vendore, sipas GJEDNJ janë: **1) A është “përcaktuar me ligj” kufizimi i urdhëruar nga gjykata vendore? 2) A ka pasur qëllim legjitim kufizimi i tillë sipas nenit 10, paragrafit 2 KEDNJ? dhe 3) A ka qenë i nevojshëm “i nevojshëm në një shoqëri demokratike” kufizimi i tillë?**¹³

76. Kundërshtarja e propozimit, nuk e konteston faktin se masa e sigurisë është e përcaktuar me ligj dhe mund të caktohet në procedurë kontestimore kur vendoset në lidhje me padi për shpifje. Po ashtu, Kundërshtarja e propozimit, nuk e konteston faktin se Gjykata Themelore në rastin konkret e ka caktuar masën e sigurisë në mënyrë që t’i mbrojë të drejtat e personalitetit të Propozuesit, përkatësisht reputacionin e tij edhe pse Kundërshtarja e propozimit e cilëson caktimin e masës si jo-proporcional dhe të padrejtë. Sidoqoftë, Kundërshtarja e propozimit e konteston Aktvendimin e gjykatës për caktim të masës së sigurisë për shkak se nuk e plotëson kushtin e tretë të vendosur nga GJEDNJ për kufizimin e lirisë së shprehjes, përkatësisht Aktvendimi nuk ka qenë i nevojshëm në një shoqëri demokratike.

77. Në lidhje me të drejtën e lirisë së shprehjes dhe rëndësinë e saj në një shoqëri demokratike GJEDNJ, në vendimin *Axel Springer kundër Gjermanisë* thekson:

¹¹ *GRA Stiftung gegen Rassismus und Antisemitismus kundër Zvicrës*, Nr. 18597/13, GJEDNJ, 9 janar 2018, paragrafi 53.

¹² *Axel Springer AG kundër Gjermanisë*, Nr. 39954/08, GJEDNJ, 7 shkurt 2012, paragrafi 76.

¹³ Po aty.

“E drejta e lirisë së shprehjes është një ndër themelet esenciale të një shoqërie demokratike dhe një ndër kushtet bazike për zhvillimin e saj dhe për vetëpërbushjen e secilit individ. Paragrafit 2 të nenit 10, **nuk i nënshtrohen vetëm “informatat” apo “idetë” që pranohen në mënyrë të favorshme apo që shihen si jo-ofenduese a si çështje indiferente, por edhe ato që ofendojnë, shokojnë dhe shqetësojnë. Të tilla janë kërkesat për pluralizëm, tolerancë dhe mendjegjerësi pa të cilat nuk ka “shoqëri demokratike”.** Siç parashihet në nenin 10, e drejta e lirisë së shprehjes i nënshtrohet përjashtimeve të cilat, sidoqoftë, duhet të interpretohen ngushtë, dhe nevoja për kufizime duhet të konstatohet bindshëm.”¹⁴

78. Sa i përket kufizimit të lirisë së shprehjes për të mbrojtur reputacionin e një personi, GJEDNJ vlerëson se a i ka balancuar drejt gjykata vendore dy vlera të garantuara me konventë: të drejtën në privatësi e cila e përfshinë edhe mbrojtjen e reputacionit në kuadër të nenit 8 KEDNJ dhe të drejtën e lirisë së shprehjes e cila mbrohet me nenin 10 KEDNJ.¹⁵

Hapësira e vlerësimit “Margin of Appreciation”

79. GJEDNJ ka vendosur disa kritere që duhet vlerësuar nga gjykata vendore gjatë balancimit të së drejtës së privatësisë dhe të drejtës së lirisë së shprehjes. Ndër të tjera ka përcaktuar se gjykatat vendore duhet të marrin në konsiderim: 1) Kontributin në debat me interes publik; 2) Sa ka qenë i njohur personi në fjalë dhe çka është tema e raportit?; 3) Metoda e marrjes së informatës dhe vërtetësia e saj; 4) Sjellja e personit që pretendon se i është shkelur privatësia në lidhje me publikimin e informatës; 5) Përmbajtja, forma dhe pasojat e publikimit dhe 6) Ashpërsia e sanksionit të shqiptuar.

1) Kontributi në debat me interes publik

80. Cilësia e arsimit dhe plagjiatura e stafit akademik të Universitetit të Prishtinës është çështje me interes publik. Gjendja e cilësisë së arsimit të lartë në Kosovë është e rëndë dhe këtë e dëshmon edhe Raporti i Progresit për Kosovën i vitit 2018, i publikuar nga Komisioni Evropian ku theksohet: «Nuk ka përparim në përmirësimin e gjendjes së arsimit dhe të mungesës së aftësive në tregun e punës».¹⁶

81. Raporti i Kundërshtares së propozimit ka kontribuar në debatin publik për cilësinë e arsimit të lartë, për rastet kur janë ngritur dyshime për plagjiaturë nëpër medie dhe për praktikat mos-ndëshkuese të Universitetit të Prishtinës në lidhje me dukuri të tilla

¹⁴ Po aty, paragrafi 79 dhe referencat në të. Përkthim jo-zyrtar i vendimit. Teksti origjinal në gjuhën angleze është si vijon: „Freedom of expression constitutes one of the essential foundations of a democratic society and one of the basic conditions for its progress and for each individual’s self-fulfilment. Subject to paragraph 2 of Article 10, it is applicable not only to “information” or “ideas” that are favourably received or regarded as inoffensive or as a matter of indifference, but also to those that offend, shock or disturb. Such are the demands of pluralism, tolerance and broadmindedness without which there is no “democratic society”. As set forth in Article 10, freedom of expression is subject to exceptions, which must, however, be construed strictly, and the need for any restrictions must be established convincingly.”

¹⁵ *Axel Springer AG kundër Gjermanisë*, Nr. 39954/08, GJEDNJ, 7 shkurt 2012, paragrafi 83, 84 dhe referencat në të.

¹⁶ European Commission, Kosovo 2018 Report, 17 April 2018, faqe 4, paragrafi 5 – përkthim jozyrtar.

negative. Universitetet publike financohen nga paratë publike të shtetit dhe për më tepër janë institucione arsimore të cilat janë me interes të veçantë shoqëror.

82. Se publikimi i Raportit është çështje me interes publik që ka kontribuar në debatin publik e dëshmon edhe vetë fakti se përfaqësuesi i Kundërshtares së propozimit, Z. Shkëlzen Gashi më datë **12 tetor 2018**, është takuar me Kryetarin e Komisionit Parlamentar për Arsim Z. Ismajl Kurteshi dhe më datë **15 tetor 2018** është takuar me Ministrin e Arsimit Z. Shyqyri Bytyqi për të biseduar në lidhje me raportin dhe të gjeturat e tij. Në takim është folur për mundësitë e adresimit dhe përmirësimit të gjendjes së arsimit të lartë në Kosovë, dhe janë dhënë zotime nga krerët e shtetit për çështje të arsimit në lidhje me adresimin e çështjeve të ngritura në Raport.

83. Prandaj Raporti i Kundërshtares së propozimit bashkë me deklaratën e kontestuar është i mbrojtur sepse kontribuon në debatin publik për përmirësimin e çështjeve të arsimit të lartë.

2) Sa ka qenë i njohur personi në fjalë dhe çka është tema e deklaratës?

84. Në këtë segment GJEDNJ e bën dallimin në mes të personave privatë dhe personave që veprojnë në kontekst publik, si figura politike apo publike.¹⁷ GJEDNJ ka vlerësuar se individët privatë që nuk njihen nga publiku mund të kërkojnë mbrojtje më të madhe të së drejtës së tyre në privatësi, por jo në qoftë se janë figura publike.¹⁸ Për këta të fundit, kufinjte e komenteve kritike janë më të gjerë pasi që janë në mënyrë të vetëdijshme dhe të pashmangshme të ekspozuar ndaj shqyrtimit publik.¹⁹

85. Propozuesi është profesor i Fakultetit Juridik në Universitetin e Prishtinës që do të thotë se ai paguhet për punën që e kryen nga taksapaguesit kosovar. Si i tillë Propozuesi vepron në kontekst publik dhe duhet të ketë tolerancë më të madhe për kritika ndaj tij dhe punës së tij nga publiku.

86. Në vlerësimin se çfarë ka përmbajtur deklarata e kontestuar nga Propozuesi është me rëndësi të përmendet sërish që gjendja e cilësisë së arsimit të lartë në Kosovë është e rëndë dhe ky është fakt notor. Raporti ka përmbledhur rastet e plagjiaturës për të cilat është raportuar në media nga themelimi i Universitetit të Prishtinës e deri më sot. Kundërshtarja e propozimit i ka përfshirë 16 rastet për të cilat është raportuar në media duke pasqyruar praktikat mos-ndëshkuese dhe mos-adresimin e çështjeve të plagjiaturës në Universitet. Në faqe 43, paragrafi 1 i Raportit është ripublikim i artikullit të Gazetës Express.

87. Për më tepër, GJEDNJ në rastin *Boldea kundër Rumanisë* ka vendosur se deklaratat në lidhje me plagjiaturë për akademikë nuk kanë të bëjnë me jetën private të tyre por me kapacitetin e tyre si akademik.²⁰

¹⁷ *GRA Stiftung gegen Rassismus und Antisemitismus kundër Zvicrës*, Nr. 18597/13, GJEDNJ, 9 janar 2018, paragrafi 62.

¹⁸ Po aty.

¹⁹ Po aty.

²⁰ *Boldea kundër Rumanisë*, GJEDNJ, Nr.19997/02, GJEDNJ, 15 shkurt 2007, Komunikatë për shtypin nga GJEDNJ, faqe 3, paragrafi 3.

3) Sjellja e personit që pretendon se i është shkelur privatësia në lidhje me publikimin e informatës

88. GJEDNJ ka vlerësuar sjelljen e palëve në procedurë që kanë pretenduar shkeljen e të drejtës në privatësi si fakt të rëndësishëm në vlerësimin e kufizimit të së drejtës së lirisë së shprehjes.²¹ Në rastin konkret, Gjykata është dashur të marrë parasysh se artikulli “Shumë Plagjiaturë” nuk është demantuar asnjëherë nga Gazeta Express dhe Propozuesi asnjëherë nuk e ka përgënjeshtuar artikullin publikisht edhe pse ka pasur mundësi ta bëjë.

4) Metoda e marrjes së informatës dhe vërtetësia e saj

89. Sa i përket metodës së marrjes së informatës dhe vërtetësisë së saj, GJEDNJ ndër të tjera vlerëson se a ka vepruar publikuesi i deklaratës (këtu Kundërshtarja e propozimit) në mirëbesim gjatë publikimit të deklaratës në interes publik dhe a është berë raportimi duke u bazuar në një bazë faktike apo në informata të “besueshme dhe precize”.²²

90. Kundërshtarja e propozimit ka vepruar me mirëbesim gjatë publikimit të Raportit dhe Gjykata e ka pranuar qëllimin e mirë të Raportit të Kundërshtares së propozimit të dhënë gjatë seancës për caktimin e masës së sigurisë. Përkatësisht, Gjykata ka vlerësuar se qëllimi i Raportit të Kundërshtares së sigurimit nuk ka pasur për qëllim ta lëndojë askënd, por ka pasur për qëllim të bëjë mbledhjen e të gjitha rasteve të publikuara në media deri më tani që kanë të bëjnë me plagjiaturë. Prandaj mund të konstatohet se Kundërshtarja e propozimit ka vepruar në mirëbesim gjatë publikimit të Raportit që e përmban deklaratën e kontestuar.

91. Kundërshtarja e propozimit gjatë hulumtimit, e ka gjetur Gazetën Express të datës 4 shkurt 2007 ku gjendet artikulli “Shumë Plagjiaturë” në arkivin e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës. Në të njëjtin arkiv ka kërkuar nëse ka ndonjë demantim të publikuar në këtë gazetë në lidhje me artikullin “Shumë Plagjiaturë” dhe nuk ka arritur të gjejë asgjë. Mungesa e demantimit është konfirmuar edhe nga vetë Propozuesi në Padi. Pastaj, Kundërshtarja e propozimit i ka kërkuar faqet e librave të Propozuesit dhe të librit të Paul Samuelson dhe William Nordhaus, të cilat citohen në artikullin e gazetës dhe cilësohen si plagjiaturë. Paragrafet e përmendura në artikullin e gazetës, Kundërshtarja e propozimit i krahason me njëra-tjetrën për ta verifikuar vlerësimin e gazetarit Jasmin Rexhepi, autor i artikullit “Shumë Plagjiaturë”. Këtë krahasim Kundërshtarja e propozimit e bën duke e pasur parasysh Kodin e Etikës për stafin akademik të Universitetit të Prishtinës Nr.1/751 i datës 19 korrik 2013, Rregulloren për masat dhe procedurat disiplinore ndaj personelit akademik të Universitetit të Prishtinës Nr.857, i datës 11 prill 2017 dhe Kodin Penal të Kosovës.

92. Të tri këto akte e bëjnë të paligjshme plagjiaturën. Përkatësisht: Kodi i Etikës për stafin akademik të Universitetit të Prishtinës Nr.1/751 i datës 19 korrik 2013, neni 10, përcakton:

²¹ *Axel Springer AG kundër Gjermanisë*, Nr. 39954/08, GJEDNJ, 7 shkurt 2012, paragrafi 92, 101.

²² *Axel Springer AG kundër Gjermanisë*, Nr. 39954/08, GJEDNJ, 7 shkurt 2012, paragrafi 93 dhe referencat në të.

“Shkelja e standardeve të ndershmërisë intelektuale, të tilla si sjellja e pahijshme kërkimore dhe/ose keqpërdorimi i qëllimshëm i shkrimeve, hulumtimeve dhe gjetjeve të tjerëve”.

93. Rregullorja për masat dhe procedurat disiplinore ndaj personelit akademik të Universitetit të Prishtinës Nr.857, i datës 11 prill 2017, përcakton në nenin 6, paragrafi 1.15 si shkelje të rëndë: **“Shkelja e rëndë e të drejtës së autorit dhe të etikës në publikimet shkencore”.**

94. Kodi Penal i Kosovës, neni 296

“1. Kushdo që nën emrin e tij apo të dikujt tjetër, shfaq apo në ndonjë mënyrë tjetër i kumton publikut punën e mbrojtur me të drejtat e autorit ose paraqitjen e tjetrit, në tërësi apo pjesërisht, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.”

5) Përmbajtja, forma dhe pasojat e publikimit

95. Raporti ku gjendet deklarata e kontestuar i ka pesë kapituj: kapitulli i III i liston të gjitha rastet e plagjiaturës të cilat kanë qenë të raportuara në media nga viti 1985 deri në vitin 2016 kur është raportuar për rastin e fundit për plagjiaturë.

96. Faqja 43, paragrafi 1 i Raportit ku është përfshirë artikulli i Gazetës Express është ripublikim i asaj që shkruhet në artikullin “Shumë Plagjiaturë”. Nuk ka fotografi të publikuar por vetëm citohet artikulli i gazetës.

6) Ashpërsia e sanksionit të shqiptuar

97. Në fund, GJEDNJ e vlerëson edhe natyrën dhe ashpërsinë e sanksionit të imponuar në palën që pretendon shkeljen e të drejtës së lirisë së shprehjes kur e shqyrton se a ka qenë ndërhyrja e shtetit proporcionale.²³ GJEDNJ vë rëndësi të posaçme në atë se a ka shkaktuar sanksioni (këtu: masa e sigurisë) një “efekt ftohës” (“chilling effect”) ndaj lirisë së shprehjes së palës, ashtu që e ka dekurajuar atë nga ndjekja e rasteve të kritikës së ngjashme ndaj proceseve publike.²⁴

98. Në rastin konkret caktimi i masës së sigurisë është jashtëzakonisht i ashpër ndaj Kundërshtares së sigurisë për shkak se ia mohon të drejtën e lirisë shprehjes Kundërshtares së propozimit deri në vendosjen e çështjes kryesore, e cila mund të jetë diku pas 2 apo 3 vitesh. Gjithnjë duke pasur paraysh ngarkesën e sistemit gjyqësor dhe zvarritjen e lëndëve. Si e tillë masa e sigurisë është shumë e ashpër dhe jo-proportionale në raport me faktet e rrethanat e rastit dhe ka pasoja negative dhe “efekt ftofës” ndaj ushtrimit të lirshëm të lirisë së shprehjes nga ana e Kundërshares së propozimit.

99. Rrjedhimisht konsiderojmë se Gjykata Themelore në Prishtinë, me nxjerrjen e Aktvendimit për caktimin e masës së sigurisë në këtë çështje kontestuese, ka dështuar t'i përfillë dispozitat procedurale të Ligjit për Procedurën Kontestimore, e ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike dhe e ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale. Si pasojë e të

²³ *Axel Springer AG kundër Gjermanisë*, Nr. 39954/08, GJEDNJ, 7 shkurt 2012, paragrafi 109 dhe referencat në të.


²⁴ *GRA Stiftung gegen Rassismus und Antisemitismus kundër Zvicrës*, Nr. 18597/13, GJEDNJ, 9 janar 2018, paragrafet 77, 78.

këtyre shkeljeve caktimi i masës së sigurisë është cënim i të drejtës së lirisë së shprehjes të Kundërshtares së propozimit dhe të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

100. Prandaj kërkojmë nga Gjykata e Apelit që pas shqyrtimit të argumenteve të paraqitura në këtë ankesë, provave dhe shkresave të lëndës, të vendosë në bazë të nenit 209, paragrafi d LPK dhe të nxjerrë këtë:

AKTVENDIM

- I. APROVOHET si plotësisht e bazuar ankesa e Kundërshtares së propozimit OJQ Admovere kundër Aktvendimit C.nr.2884/18 i datës 8 nëntor 2018i i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm me të cilën është caktuar masa e sigurisë naj Kundërshtares së propozimit.
- II. ANULOHET Aktvendimi C.nr.2884/18 i datës 8 nëntor 2018 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm me të cilin është aprovuar si e bazuar kërkesa e Propozuesit të sigurimit Mejdi Bektashi nga Prishtina.


Avokate - Attorney at law
RINA KIKA
Prishtinë

Rina Kika

Avokate (sipas autorizimit në shkresat e lëndës)

rina@kika-associates.com

Kika & Associates
Edith Durham B1 H1 Nr.11
10000 Prishtinë